

Diagnoza të pasigurta: Si testet holandeze rrejtshëm të deklaruar për COVID nga Kina përfunduan në Maqedoni, SHBA dhe vendet e BE-së

Testi i shpejtë imunologjik që në Maqedoni ofrohej në spitalin “Sistina”, nuk është nga prodhues holandez, siç pohoj, ndërsa u zbulua se edhe rrejtshëm deklarohet si më i saktë se sa vërtet është. Testi për të cilin pohoj se është 92.9 për qind i saktë, sipas eksperëve është thjeshtë “bërlllog”. Ekipi i reporterëve zbuloi probleme shumë më të mëdha në nivel global me këtë test. Testi është kinez dhe nuk është i saktë, i riambalazhuar në Holandë dhe i ofruar si evropian. Zbuluam të paktën tre brende që kanë shitur teste të bëra prej prodhuesit kinez me etiketa evropane dhe amerikane. Testet u janë shitur autoriteteve, institucioneve shëndetësore dhe klinikave në vend, përfshirë Francën, Britaninë e Madhe, Indonezinë dhe Rusinë. Të blihen dhe të mundësohen teste si këto është legale. Mirëpo, mashtrimi i qytetarëve për prejardhjen e vërtet të tyre dhe për performansat e testit, megjithatë nuk është.

Autorë: Sashka Cvetkovska, Aubri Belford, Sesilija Anesi, Gavin Broving

Raportim shtesë: Lorenzo Bagnolo, Dragan Peço, Antonio Bakero, Maja Jovanovska, David Ilievski, Marija Horban, Atanas Çobanov, Romana Pulet, Mishel Simons, Karlin Kupjer, Dimitar Velikovski.

Ky hulumtum është bashkëpunim midis IRL-Maqedoni, IPRI-Itali, Mullpri Media, Bivol-Bullgari, Krik-Serbi, Investiko-Holandë, Vazni storii-Rusi dhe Tempo-Indonezi.

Në një periudhë prej disa ditëve, nga fundi i marsit, shtetasi maqedonas Roxher Zekirovski i kishte të gjitha simptomet e njihura për Covid-19; temperaturë të lartë, dhimbje në muskuj dhe kollë të thatë. Mirëpo, sipas pyetsorit epidemiologjik, ai nuk i plotësoi kushtet për test laboratorik në spitalin e shtetit.

Në vend të kësaj, Zekirovski vendosi për atë që dukej si një alternativën më e mirë: një test i përgatitur në Holandë – i cili bëhet në një klinikë private për vetëm 20 euro – mund ta zbulojë sëmundjen me një shkallë të lartë saktësie për vetëm disa minuta. Ose të paktën kjo ishte ajo që po e mendonte kur u nis për në shtëpi duke u kthyer nga klinika, i lehtësuar me rezultatin negativ të testit.

Tre ditë më vonë, 45 vjeçari Zekirovski ishte i vdekur. Rezultatet zyrtare prej testit post-mortum treguan se ai vërtet ishte i infektuar me SARS-KoV-2, virusi që shkakton COVID-19.

Bashkëshortja e Zekirovskit, Gjultena, tha se testi i rremë negativ i përballi me rreziqe të mëdha e të frikshme.

“Kur në test doli negativ, të gjithë ishim shumë të lumtur”, tha ajo. “U përqaftuam dhe u puthëm, fëmijë dhe prindër”. “Si mund ta dinim?”

Edhe pse është e pamundur të thuhet nëse Zekirovski do të mbijetonte sikur të ishte ndryshe, vdekja e tij është ilustrim mbresëlënës për kërcënimet e asaj që shumica shpresuan se është armë vendimtare për luftën kundër pandemisë: teste të shpejta për antitrupa.

Për dallim nga testet tipike molekulare, që kërkojnë proteina të virusit SARS-KoV-2, ndërsa rezultatet mund të jenë gati edhe pas disa ditëve, testet e shpejta kërkojnë antitrupa të prodhuara prej sistemit imunologjik derisa lufton virusin. Rezultatet zakonisht janë të gatshme për 10- deri 30 minuta.

Shpresat fillestare se këto teste do të ndihmojnë në luftën kundër virusit, shpejtë u zhdukën pasi u zbulua se këto teste, kryesisht të prodhuara në Kinë, janë shumë më të pasakta sesa fillimisht mendohej. Por, hulumtimi i OCCRP dhe i partnerëve, zbuluan probleme më të mëdha me tregun global për testet e shpejta.

Shikim i trurbullt në tregun global për testet e shpejta

Del se asgjë prej asaj që besoi Zekirovski për testin e shpejtë nuk ishte e saktë. Asnjëherë nuk do të duhej të ofrohej si mjet për diagnostifikim e as reklamimi nuk ishte i saktë.

Gjithashtu, reporterët zbuluan se testet as që ishin të përgatitura në Holandë. Në vend të kësaj, testi – i shitur prej kompanisë holandeze Inzek International Trejdin me brendin Biozek – ishte njëri prej të paktën tre brendeve të testeve të shpejta për virusin korona të prodhuar prej prodhuesve evropian dhe amerikan, të cilët në faktë janë ribrenduar prej testit të njohur kinez. Testi i prodhuar prej Hangzhou Alltest Biotex Co, LTD, në disa hetime të pavarurura u tregua si më pak i saktë se sa pohohet. Qeveria e Britanisë së Madhe anuloi porosinë e testeve, pasi kinse zbuloi se nuk arritën të plotësonin standardet e tyre për saktësi.

Por megjithatë, miliona teste janë shitur në mbarë botën. Shpesh shiten edhe promovohen si prodhim cilësorë evropian, në kundërshtim të qartë me prodhuesit kinez më pak prestigjioz.

Testet e njejta kineze, me emra të ndryshëm të brendeve u përdorën nga institucione shëndetësore dhe qeveri të vendeve, përfshirë edhe Spanjën, Italinë, Francën, Britaninë e Madhe, Indonezinë, Rusinë dhe Vatikanin. Ato përfunduan në duart e tregtarëve me pakicë në internet, të cilët ua shesin personave që nuk janë puntorë shëndetësorë – praktikë që bie në kundërshtim me udhëzimet për përdorimin e sigurtë. Ato madje edhe u kontrabanduan në Ukrainë në një dërgesë me konfeksion.

Blerja dhe ribrendimi i këtyre testeve është legale edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në vendet e Bashkimit Evropian. Megjithatë, informimi i pasaktë i konsumatorëve dhe pacientëve, është i paligjshëm.

Testi negativ i rrejtshëm është katastrofë

Testet e shpejta bëhen me marrjen e një mostre të vogël gjaku që vendoset në një shirit të vogël prej plastike për t'u kontrolluar prania e antitropave të virusit. Shumica e testeve kërkojnë dy lloje antitropash: Imunoglobulin M (IgM), që paraqitet zakonisht në fazën fillestare të sëmundjes, dhe Imunoglobulin G (IgG), që paraqitet në fazat më të vonshme dhe qëndron më gjatë.

Testet bëhen shpejtë, por nuk janë mjaftueshëm të sakta për të diagnostifikuar pacientë të veçantë me Covid-19, thonë ekspertët shëndetësorë. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) aktualisht këshillon që këto teste të përdoren vetëm për ndjekjen e komunitetit ose bashkë me teste më të sigurta molekulare, të cilat kërkojnë material gjenetik të virusit, por që u duhet një kohë më e gjatë për të marrë rezultatet, sepse ato duhet të realizohen në laborator.

Bashkë me ventilatorët dhe maskat, kishte kërkesa të madha edhe për testet e shpejta në fazat e hershme të pandemisë. Kompletet për testim nga Kina fituan publicitet të madh. Dërgesat kineze për ndihma dhe shitje në vendet evropiane të prekura nga virusi, shpejt u përballën me kundërthënie. Spanja ia ktheu serinë e kompleteve për testim prodhuesit

kinez Shenzhen Biozi Bioteknologji, pasi u vërtetua se saktësia e tyre është vetëm 30 për qind.

Testi Biozek shitet në spitalin Sistina si test holandez, por ai është test kinez

Në letër, brendi kinez Alltest është shumë i saktë. Kompania, me seli në kryeqytetin e provincës kineze Zheijang, është prodhues shumëvjeçar i kompleteve për testim për zbulimin e infeksioneve të zakonshme, të drogës dhe të shtatëzansë.

Alltest publikoi një studim klinik duke pohuar se testet e tyre janë 92,9 për qind të saktë gjatë zbulimit të IgM dhe 98,6 për qind për IgG.

Por, studimet e pavarura vërtetuan se testet nuk janë as për së afërmi të saktë aq sa pohohet. Një studim tjetër spanjoll zbuloi se Alltest ka dhënë rezultate negative të rreme në më shumë se gjysmën e testeve të bëra.

Një nga autorët e studimit, Huan Kuadros Gonzales, deklaroi për OCCRP se përqindja e testeve negative të rreme ka rënë në mënyrë drastike në më pak se pesë për qind gjatë katër javëve pas simptomave të para, me rritjen e antitrapave.

Duke i ditur këto kufizime, Kuadros dhe kolegët e tij kanë qenë në gjenjde t'i përdorin testet si instrument alternativ për skring bashkë me testet në laboratoritë molekulare. Por, kjo ngecje njëmuje "nuk është përmendur në broshurat e testeve dhe këtu qëndron problemi", thotë ai.

Marin de Jonge, shkencëtarë i përfshirë në studimin e Covid-19 në Qendrën Medicinale të Universitetit Radboud në Holandë, tha se testet negative të rrejshme mund të jenë shumë të rrezikshme.

"Kur doni të përcaktoni nëse dikush është i infektuar, rezultati pozitiv i rrejshëm nuk është problem i madhë, sepse pasoja e vetme është ajo që dikush izolohet për asgjë", tha De Jong. "Por, negativ i rrejshëm është katasrofë", tha ai, sepse nëse dikujt i lejoni lirshëm të lëvizë, mund t'i rrezikojë të tjerët në komunitet.

Qeveria britanike në fillim të prillit anuloi një porosi shumëmilionëshe për kompletet e Alltest, pas shqyrtimit të udhëhequr nga Universiteti i Oksfordit, i cili kinse ka zbuluar se

Alltest dhe një markë tjetër kineze, nuk kanë arritur t'i plotësojnë standardet e tyre të nevojshme të saktësisë.

Rezultatet e kërkimeve klinike të publikuara prej "Alltest", që konfirmojnë saktësi prej 92,9 dhe 98,6 për qind janë "bërlllog", deklaroi Kler Stendli, profesor asistent i kërkimeve në Qendrën për Shkencë Globale Shëndetësore dhe Siguri të Universitetit Xhorxhtaun.

"Nuk ka informata për gjendjen klinike të pacientëve", tha Stenli. "Nuk e dimë nëse kanë qenë të hospitalizuar, nuk dimë nëse ishin rastësisht të përzgjedhur prej komunitetit, nuk dimë nëse kanë simptoma të lehta, nuk dimë se si i kanë identifikuar. Nuk ka informata për pëlqime etike që iu janë dhënë për të siguruar se ata pajtohen të jenë pjesë e studimit. Këto janë të gjitha aspekte themelore".

Studimet klinike të testeve të shpejta duhet të krahasohen me rezultatet e fituara prej kompleteve me teste më të sakta laboratorike, tha Stenli. Studimi klinik, megjithatë, nuk përfshinë informata të atilla dhe nuk jep indikacione për atë se ku mund t'i gjeni.

Kjo nuk do të thotë se testet janë të padobishme. Në pajtim me këshillat e OBSH, Alltest ende mund të jetë një mjet i dobishëm për skrining, bashkë me testimin molekular, tha Stenli. Ato janë gjithashtu të dobishëm si mjet për krahasimin e studimeve në mbarë komunitetin për përhapjen e sëmundjes.

Në fakt edhe Alltest publikisht tha se ky është përdorim i drejtë i testit të tyre. Në një deklaratë të publikuar nga ana e kompanisë menjëherë pas anulimit të porosisë britanike, kompania tha se prodhimi i tyre nuk është "I përshtatshëm për një analizë të hershme" dhe se duhet të përdoret si "metodë shtesë" për testet laboratorike.

Alltest nuk pranoi të përgjigjet në pyetjet me shkrim të OCCRP.

"Ndoshta ka një fjalë të gabuar"

Të paktën tre brende të tjera me seli në Evropë dhe SHBA aktualisht i shesin modelet e Alltest nwn brendet e tyre, zblujonë reporterët.

Gazetarët e OCCRP dhe IRL ishin në gjenjde t'i gjejnë testet duke kërkuar numrat vendimtarw nga studimi original klinik i Alltest, si dhe variacionet e numrit referent për test modelet, INCP-402. Këto informata poashtu u kryqëzuan me dokumente për regjistrimin e

kompanisë dhe me informata nga ImportGenius, baza komerciale e të dhënave për import-eksportin.

Më i theksuar prej tyre ishte prodhuesi i testeve “Biozek”, Inzek International Trading BV, i cili gjendet në qytetin holandez Apeldorn.

Deri para do kohe, kompania i reklamonte testet e veta për korona virusin në ueb faqen e saj si prodhim holandez duke i etiketuar me shenjën “CE”, duke shënuar se janë bërë sipas standardeve të fushës ekonomike evropiane.

Pohimi se janë holandeze është mashtrimi kryesor për disa blerës. Me 8 prill, kompania shtetërore farmaceutike në Indonezi, PT Kimja Farma, publikoi furnimzimin e 300 mijë komplete testesh të Biozek, duke pohuar se kanë qenë “të zhvilluara sipas rregullativave të BE”.

Mustafa Hamid, menaxher për kontrollin e cilësisë në Biozek, u citua në botimin e njejtë ku thotë : “Testet janë zhvilluar dhe prodhuar sipas rregulloreve shumë të rrepta të BE-së dhe të Holandës. Këto rregullativa nuk lënë hapësirë për gabim dhe prandaj bëhet një prodhim shumë i sigurtë”.

Por, në fakt, testet ishin zhvilluar dhe prodhuar në Kinë nga Alltest, zbuloi drejtori ekzekutiv i Inzek – Zaki Hamid, gjatë një bisede me një gazetar.

Ai tha se kompania holandeze zakonisht zbaton kontrolle të veta të cilësisë në Irak dhe mbanë takime pune në Holandë, por se asnjëri nga këto hapa nuk ka qenë i mundshëm për testet për antitruapat e Covid-19, si rezultat i mbylljes së kufijve.

“Kompania në Kinë është prodhues profesional dhe ata kanë certifikata zyrtare”, tha Hamid. “Ne u besojmë qindpërqind”.

Në pyetjen pse testet ishin promovuar si prodhim holandez në ueb faqe, Hamid tha: “Ndoshta ka një fjalë të gabuar. Ndoshta duhet ta korigjojmë atë”. Ueb faqja është ndryshuar ditën tjetër, më 29 prill dhe u hoqën të gjitha promocionet dhe tekstet lidhur me testin e shpejtë të Biozekut.

Andi Prazos, drejtor i Kimia Farma të Indonezisë tha se kompania shtetërore ishte e bindur se testet janë bërë në Holandë dhe se madje ka dërguar personelin e tyre në uzinën e Inzek në Holandë.

“Para transaksionit, u bindëm se kompania është kredibile dhe ka linjë të sajën prodhuese. Ambasada e Indonezisë në Holandë gjithashtu na ka ndihmuar”, tha ai. “Testet tanimw janë shpërndarë në 14 rajone dhe krahina të Indonezisë”, shtoi ai.

Si përgjigje ndaj pyetjeve të gazetarëve, nga Fondacioni për Kodin e Sjelljes në Holandë për Pajisje Medicinale (GMH), deklaruan se nuk janë në gjendje të komentojnë për raste individuale, por qartë është e papëlqyeshme që palët e lidhura me GMH t’i reklamojnë pajisjet medicinale në mënyrë të papërshtatshme, të pabazuar dhe mund t’i mashtrojnë njëri-tjetrin. Ankesat duhet të shqyrtohen nga një gjykatë civile ose nga Komiteti i ligjeve për reklamim në vend, thuhet në raport.

Teste për Vatikanin me ndihmën e miqve të Trampit

“Ende është e pazakonshme, e paqartë dhe jo mjaftueshëm transparente për konsumatorin”, tha Stenli, “por mund të jetë legale në pajtim me ligjet dhe njëra prej atyre praktikave për të cilat nuk dinim deri tani, sepse asnjëherë nuk kemi qenë të interesuar për diagnostikë.”

Testet e Inzek “të bëra në Holandë” u treguan si të popullarizuara. Sipas Hamid, kompania deri tani ka shitur dhe ka dërguar mbi 1.6 milionw komplete testesh në mbarë botën. Klientët më të mëdhënjë të kompanisë janë në Indonezi, Rusi, Holandë, Kuvajt, Arabinë Saudite dhe në Irak, tha ai.

Madje edhe kisha në Vatikan ka porositur 700 teste të Biozek, publikoi gazeta italiane La Stampa, me ndihmën e Paolo Zampolit, biznesmen italian që jeton në Nju Jork, i cili është ambasador i Republikës Domenikane në Kombet e Bashkuara dhe i cili kinse ka organizuar aheng në vitin 1998, ku presidenti i tashëm amëtrikan, Donald Tramp është njoftuar me bashkwshorten e tij të tanishme Melania Knaus. Zampoli publikoi rolin e tij në marrëveshjen për testet e “Biozek” me fotografi në faqen e tij në Instagram.

Amerikane, por kineze

Duke i krahasur numrat referentw të testeve dhe numrat për zbulimin e antitropave, gazetarët ishin në gjenjde të zbulojnë të paktën dy ribrendime të tjera në treg të completeve të Alltest.

Njëri prej tyre shitet me brendin e Skrin Italia, prodhues i testeve në rajonin italian Umbria.

Ueb faqja e kompanisë përfshinë deklarime për pajtueshmëri të KE – mekanizëm për vetë-njoftim për marrjen e shënjës “CE” – ku kompania italiane përmend veten si prodhues i tre testeve të shpejta për koronavirusin, të cilat përmbajnë numra referentë të Alltestit, duke përfshirë edhe dy variante të INCP-402, kompletin e njejtë për testim që e zbaton Biozek. Kompania, gjithashtu është regjistruar në Ministrinë italiane të Shëndetësisë si prodhues i testeve, sipas dokumenteve të dorëzuar. Ligji italian lejon blerje dhe vendosje të sërishme të testeve për import, derisa importuesi ushtron kontroll mbi cilësinë dhe ripaketimin dhe e zbulon prodhuesin origjinal nëse kërkohet një gjë e tillë.

Skrin Italia refuzoi të përgjigjet në pyetjet e gazetarëve. Kompania kumtoi se nuk mund të zblujë prodhuesin origjinal të testeve ose ku janë shitur testet.

Gjithashtu të qasshme në Itali, sikurse edhe në shumë vendet tjera janë edhe testet e shitura nga Akro Biotech, kompani me seli në Ranço Kukamonga, Kaliforni. Kompania shet teste në nivel global me dy brende, Akro dhe Juscek, të cilët mbajnë variante të numrit referent Alltest të INCP-420. Gjithashtu, shet edhe teste të tjera të shpejta të gjakut për zbulimin e drogës, sëmundjeve ngjitëse dhe markerë për gjendjen e sëmundjeve të zemrës.

Dokumentet e dorëzuar në Drejtorinë për Ushqim dhe Barna të SHBA-së (FDA) tregojnë se testet e Akro Biotech janë prodhuar nga Alltest. Marrëveshjet e tilla për ripaketim janë legale në SHBA deri sa ato janë të deklaruara në mënyrë të përshtatshme nga FDA dhe merret i ashtuquajti autorizim për përdorim të shpejtë (EUA). Shënimet e FDA tregojnë se është parashtruar aplikimi EUA për testin, por se ende nuk është miratuar.

Reporterët nuk zbuluan dëshmi se Akro Biotech ka shitur complete për testet për koronavirusin në SHBA, por arritën të gjejnë një sërë blerësish në vendet e huaja. Gazetarët i gjetën testet në shitje nga distribuesit në Indi, Kili, Brazil, Spanjë, Itali, Belgjikë dhe në Finlandë.

Testet për koronavirus të Akro Biotech në Evropë shiten me shenjën “CE”, ku prodhuesi përmendet si kompani me seli në Kaliforni, sipas deklarimit për përshtatje të publikuar në internet.

Në një bisedë telefonike, drejtori ekzekutiv i Akro Biotech, Xho Fen, i luti gazetarët të dërgojnë pyetje përmes e-mailit, por nuk u përgjigj në ato.

Në Itali, njëri prej vendeve më rëndë të goditur nga Covid-19, qeveria kombëtare iu shmang testeve të shpejta për antitropa.

“Lidhur me të ashtuquajturin 'test i shpejtë' me një pikë gjaku, ne nuk i pranojmë si valide dhe i përmbahemi mendimit të bashkësisë ndërkombëtare të shkenctarëve për atë”, tha zëdhënësi i Ministrisë italiane të Shëndetësisë, Çezare Bukiçio.

Shumë autoritete lokale në sistemin e decentralizuar shëndetësorë të Italisë kanë blerë këto teste përkundër asaj se “qartë janë këshilluar kundër një gjëje të tillë”, tha Bukiçio.

“Mund t’ju siguroj se disa rajone madje ishin të detyruara t’i hedhin, sepse testet nuk funksionojnë”, tha ai.

Edhe përkundër kësaj, testet e Akro Biotech u janë shitur vetëqeverisjeve lokale në të paktën tre rajone italiane. Edhe Insitucioni Lokal Shëndetësorë në qytetin e Kagliari dhe spitali në Napoli kanë blerë 12.500 komplete Akro Biotech, sipas tenderit të publikuar nga të dy institucionet.

Xhanfrank Tedeshi, kryetar komune i Srxhio, të rajonit të Abrucos, i bleu testet e shpejta të Akro Biotech për 1.700 banorë të qytetit nga fundi i marsit, përkundër vërejtjeve të qeverisë rajonale. Ai tha se është i knaqëur nga rezultatet.

“Skriningu ynw zbuloi persona tw infektuar që më vonë ishin konfirmuar me testet me strisho, por dhe me antitropa te personat që tanimë kanë kaluar nwpwr kwtw sëmundje”, tha Tedeshi.

Në pjesën më të madhe të botës, problemi duhet të ndërlidhet më pak me vet testet – që bile edhe shkencëtarët skeptikë thonë se janë të mirë për disa gjëra, siç është skringu i komunitetit, ndërsa më shumë me shitës dhe klinika që në mënyrë të papërshtatshme i reklamojnë dhe administrojnë.

Gjatë hulumtimit, gazetarët zbuluan disa raste se teste të shpejta u shiten drejtpërdrejtë klientëve prej tregtarëve me pakicë përmes internetit ose punojnë përmes platformave të sigurta për mesazhe, siç është Telegrami.

Nëse doni të zbuloni ku shiten prodhimet evropiane dhe amerikane të deklaruar rrejtshëm , klikoni në këtë hartë.

Një online-distributor, me seli në Itali, u shiti 25 teste të Akro Biotech gazetarëve pa mos e kontrolluar nëse bëhet fjalë për profesionist shëndetësorë ose furnizues medicinal–përkundër asaj që në ueb faqen e tyre pohojnë se i ndjekin rekomandimet që dekurajojnë shitjen për maswn.

Në disa raste, nuk ishte e mundur të ndiqet udhëtimi i testeve nga prodhuesit deri te shitësit. Në raste të tjera, gazetarët ishin në gjendje ta ndjekin rolin e kompanive ndërmjetësuese dhe të falsifikuesve, prania e të cilëve në zinxhir ndihmoi fshehjen e prejardhjes së testeve dhe kontribuoi për keqpërdorimin e tyre nga shitësit dhe ofruesit e shërbimeve mjekësore.

Në Maqedoni, testin që e bëri Zekirovski e siguroi ndërmjetësi zvicerian Spring Heltker, i cili shiti 500 teste të brenduara Biozek në spitalin “Axihi Adem Sestina” për 8 euro për një test nga mesi i marsit, sipas fakturës së marrë prej gazetarëve. Testet vijnë prej serisë së 100 mijë testeve të dërguara nga Inzek deri te Spring Helker, deklaroi për gazetarët drejtori ekzekutiv i Inzek, Hamid.

Gjithsej, 50 mijë teste të Biozek janë importuar në Maqedoninë e Veriut, sipas procesverbaleve doganore. Numri më i madh i atyre dërgesave janë realizuar përmes ndonjë ndërmjetësi tjetër, pasi dështoi lidhja me kompanisë zviceriane dhe asaj holandeze.

Vasaj Bati, konsulent i Spring Heltker, tha se Inzek i ka mashtruar duke i bindur se testet janë bërë në Holandë.

“Nuk ishte e qartë se testi është plotësisht i prodhuar prej kompanisë kineze dhe se çdo gjë ishte prodhuar në Kinë”, tha Bati. “Një numër i madh i distribuesve pohojnë se prodhohet në Holandë, në kuti shënohet se janë prodhuar në Holandë”, tha ai. “Tani të gjithëve u treguam se nuk janë nga Holanda, por nga Kina”.

Kjo edhe më tepër shtoi hutinë: Spring Heltek ua ka shitur testet e Biozek me brendin e vet blerësve potencial, sipas materialeve promovuese që i kanë marrë reporterët prej online brokerëve. Kjo ishte një masë e përkohshme e përdorur vetëm para se të firmoset marrëveshje me klientët, tha Bati, me qëllim që t'i pengojë ato të refuzojnë ndërmjetësin dhe të shhkojnë drejtpërdrejtë në kompaninë holandeze.

Në Maqedoninë e Veriut, testi i Biozek ishte përdorur si pjesë e fushatës agresive të marketingut të spitalit Axhibadem Sistina, që shpejtë pastaj ra para rregullatorëve. Testet “e shpejta dhe efikase” u promovuan përmes internetit dhe përmes reklamave të paguara në mediat lokale.

Në prill, Agjencia për Barna dhe Pajisje Medicinale në vend (MALMED) urdhëroi spitali t'i heq të gjitha reklamat për testet, duke zbuluar se spitali nuk ka arritur në mënyrë adekuate t'i kumtojw opinionit dobinë e kufizuar klinike të testeve, deklaroi drejtoresha e Agjencisë, Vizara Riza për OCCRP. Spitali gjithashtu i ka reklamuar testet pa mos marrë miratim paraprak nga MALMED, tha Vizara.

Edhe një test negativ i rrejshëm i Biozek në spitalin Axhibadem Sistina ishte i gazetarit të njohur Goce Mihajlovski, që rezultoi me vetë-izolim të drejtuesve të dy partive më të mëdha në vend, pasi bashkë me të u paraqitën në një emsion televiziv.

Si përpjigje ndaj pyetjeve, spitali Axhibadem Sistina në një deklaratë tha se testet përdoren vetëm për skring masiv të komunitetit. Spitali gjithashtu, jashtë rregullave, deklaroi se testet ishin miratuar për përdorim nga FDA amerikane. Zoran Zaev, në një bisedë me IRL tha se gazetari ishte korrekt dhe nuk ka mundur ta dinte nëse ka qenë i sëmurë apo jo.

Spitali kumtoi se i kishte dorëzuar pyetjet e gazetarëve deri te ambasada holandeze në vend “me qëllim që të mbrohet prodhuesi i njohur nga vendi partner dhe marrëdhëniet e mira tregtare”.

Problemet me testet Biozek nuk penguan Axhibadem Sistinën t'i eksportojë në Serbinë fqinje. Faktura e siguruar nga gazetarët tregon se spitali maqedonas ia ka shitur 300 komplete nga 10 euro për një test Institutit serb të sëmundjeve kardiovaskulare në Dedinje, drejtor i të cilit është Millovan Bojiq, ish-ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e autokratit të vdekur, Slobodan Millosheviq.

Duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve, Bojiq tha se testet janë marrë si donacion dhe se Instituti serb nuk ka paguar asgjë për ato. Megjithatë e përdori kompletin për testimin e 14 pacientëve për koronavirus.

Në një rast, testet e Biozek udhëtuan edhe më gjatë. Nga fundi i marsit, policia sekrete e Ukrainës, e njohur si Shërbimi për siguri, konfiskoi testet e Biozek që ishin kontrabanduar në vend, kinse në një konteiner për konfeksion i dërguar nga Turqia.

Drejtori ekzekutiv i Inzek, Hamid deklaroi se ka qenë në kontakt me autoritetet e Ukrainës për konfiskimin, por nuk kishte idenw se si testet mund të riorientohen për tregun e zi.

Inzek dërgon prodhimet e veta deri te furnizuesit e mbrojtjes shëndetësore, të cilët, “janë njerëz me prejardhje të ndryshme dhe ato shesin në rajone të ndryshme të botës, ndërsa ne nuk dimë deri ku”.

Studime dhe certifikata klinike	Shkarko dokumentet
Certifikatë e Biozek Holandë;	Shkarko
Studim klinik Altest	Shkarko
Studim klinik i Spring Healtker	Shkarko
Paketim i Biozek në Lituani	Shkarko
Certifikatë e Bioteh nga Ukraina – klon i Biozek	Shkarko
Cerfifikatë e Akrobiotek në Gjermani	Shkarko
Studim i paemëruar klinik identik me të tjerat	Shkarko
Deklarim për pajtueshmëri të BE-së për Inzek	Shkarko